



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Qeveria -Vlada - Government**

*Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,  
Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry And Rural  
Development*

Duke u bazuar në nenin 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, dhe neni 4 paragrafi 4.1 pika f) të Ligjit Nr. 2004/13 për Materialin Fidanor të datës 28 maj 2004, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nxjerr sa vijon:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.14/2008**  
**Për kategorizimin e materialit fidanor**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kriteret për kategorizimin e materialit fidanor për pemët frutore.

**Neni 2**  
**Përkufizimet**

Termet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këtë domethënie:

“**autoritet licencues**” nënkupton autoritetin i cili bënë licencimin e personave që merren me materialin fidanor;

“**inspektor**” nënkupton personin e autorizuar nga Ministria;

“**C.A.C – Conformitas Agraria Communitati**” nënkupton materialin shumues frutorë dhe pemëve që i plotësojnë kushtet minimale të përshkruara për këtë kategori relative në lidhje me llojet përkatëse;

“**C.A.C – Conformitas Agraria Communitati**” nënkupton materialin shumues frutorë i cili i nënshtrohet analizave laboratorike si dhe kontrolleve zyrtare të shërbimit të inspektorëve fitosanitar;

“**etiketa**” nënkupton përmbajtjen e shkruar grafike që përmban të dhënat për materialin fidanor;

“**institucion i autorizuar**” nënkupton institucionin e autorizuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për analiza laboratorike të materialit fidanor.

### **Neni 3**

Në Kosovë aktualisht prodhohet material fidanor i kategorisë CAC- Conformitas Agraria Communitati.

### **Neni 4**

4.1 Nëse kategoria e materialit fidanor e përcaktuar nga nenin 3 i këtij udhëzimi administrativ nuk i plotësojnë kriteret për kualitet dhe pastërti varietore, inkurajohen prodhuesit e materialit fidanor që të orientohen në prodhimet e materialit fidanor në një kategori më të avancuar e të emërtuar si C.A.C për pemë frutore.

4.2 Kategoria e materialit fidanor si C.A.C e avancuar identifikohet me etikete me ngjyre të pertokallët.

### **Neni 5**

Personat të cilët dëshirojnë të prodhojnë material fidanor të kategorisë C.A.C të avancuar duhet të plotësojnë këto kriteret:

- a) dëshminë zyrtare për pastërti varietore, e cila duhet të deklarohet nga eksperti përgjegjës i cili bënë mbikëqyrjen e pemishtes amë;
- b) dëshminë për analizat e kryera laboratorike për virozat dhe bakteret në laboratorët e autorizuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- c) procesverbalin për kontrollet zyrtare të inspektorit fitosaniotar.

### **Neni 6**

6.1 Standardet e materialit fidanor janë të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ MA-NR.05/2005 për caktimin e standardeve të materialit fidanor për pemë, hardhi dhe perime të dt. 24.02.2005.

6.2 Prodhuesit e materialit fidanor sipas nenit 4 paragrafit 4.2 të këtij udhëzimi administrativ janë të obliguar të ofrojnë dokumentacionin për origjinën e materialit fidanor për shumim – nënshartesave dhe mbishartesave.

### **Neni 7**

#### **Zbatimi**

Plotësimi i kriterëve të kategorisë së materialit fidanor C.A.C e avancuar nga prodhuesit e materialit fidanor të përcaktuara në nenin 4 të këtij udhëzimi administrativ verifikohen nga inspektori fitosanitar me procesverbal.

### **Neni 8**

#### **Etiketa**

8.1 Etiketa përgatitet dhe lëshohet nga organi kompetent i Ministrisë të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ MA-NR.27/2005 për paketimin dhe etiketimin e materialit fidanor të dt.10.11.2005.

8.2 Dimensionet e etiketës janë të përcaktuara me udhëzimin administrativ të përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni.

## **Neni 9** **Përmbajtja e etiketës**

Përmbajtja e etiketës zyrtare për kategoritë e materialit fidanor C.A.C më të avancuar përmban këto të dhëna:

1. emri i subjektit-fidanishtes;
2. numri identifikues i prodhuesit;
3. lloji;
4. varieteti;
5. nënshartesa;
6. viti i prodhimit;
7. mosha;
8. numri i copave në deng – 1, 10, 20;
9. numri i vërtetuar i deklaracionit;
10. kategoria dhe
11. numri serik.

## **Neni 10**

Moszbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ sanksionohet me ndëshkimet e përcaktuara me nenin 21 të Ligjit Nr.2004/13 për Materialin Fidanor.

## **Neni 11** **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Prishtine, më 27.03.2008

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministri,  
Idriz Vehapi

---